



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE  
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE  
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY  
Nr. Prot.: 399/13 Data: 15.01.13  
Br. Prot.: \_\_\_\_\_ Datum: \_\_\_\_\_  
Prot. No.: \_\_\_\_\_ Date: \_\_\_\_\_  
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 399/13  
Datë: 15.01.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.01.2013 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Për programet jo formale kohëzgjatja e validimit për kualifikimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit do të bazohet në marrëveshjet që kane këto institucione me zhvilluesit e këtyre kualifikimeve.
2. Kohëzgjatja e akreditimit të institucioneve që ofrojnë, vlerësojnë dhe lëshojnë këto kualifikime bazohet në rekomandimet sipas raporteve vlerësuese nga panelet, por duhet plotësuar kushtin paraprak.
3. Të gjitha Institucionet që kane qenë në proces të validimit dhe akreditimit për kualifikimin TIK, kërkohet që të sjellin në zyret e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve origjinalin dhe kopjen e marrëveshjes me zhvilluesit e kualifikimit TIK çdo vit kalendarik me datë të caktuar nga AKK.
4. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 15.01.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga:

Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit,

Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe në dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

**2.2** Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

**3.** Kushti i parashtruar për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushet në afatin e caktuar, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

**4.** Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

**5.** Vendimi u dërgohet:

5.1 Institucioneve aplikuese;

5.2 AKK-së.

  
Kryetari i KD së AKK-së  
Ragip Gjoshi